



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 908/ 12 prot.,

Datë 22.04.2026

**V E N D I M**

**Nr. 532/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtare
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.04.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.484/2026, datë 08.04.2026, në procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur - Punë publike (kontratë me çelsa në dorë)*” me Nr. REF-76024-02-12-2026, me objekt: “Furnizimi me ujë i zonës së Gjirit të Lalzit (Kontratë me çelsa në dorë)” me fond limit 65.000.000 (Gjashtë dhjetë e pesë milion) lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 02.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a.
- Ankimues:** OE “G.A.C.” SHPK me NIPT L61619031A dhe me adresë, Rruga Pylla e Zeqirit, Nr Pas 211/158, ZK 1605, Sauk, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a. me adresë L.17 Rruga Dalip Peza, Durrës.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e

*Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 08.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.484/2026, ku vendosi:

- 1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “G.A.C.” Shpk, në procedurën e prokurimit “Procedure e Hapur - Punë publike (kontratë me çelsa në dorë)” me Nr. REF-76024-02-12-2026, me objekt: “Furnizimi me ujë i zonës së Gjirit të Lalzit (Kontratë me çelsa në dorë)” me fond limit 65.000.000 (Gjashtë dhjetë e pesë milion) lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 02.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetës Kanalizime Durrës sh.a.*
- 2. Autoriteti kontraktues të kryejë rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në këtë vendim.*
- 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “G.A.C.” Shpk.*
- 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën përcjellëse me nr. 82/25 prot., datë 10.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 908/9 prot., datë 16.04.2026, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetës Kanalizime Durrës sh.a, ka dërguar me shërbim postar, informacion mbi zbatimin e vendimit të KPP-së Nr. 484/2026, datë 08.04.2026.

*-Procesverbal rivlerësimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 82/24 prot., datë 10.04.2026;*

## II

### Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

#### Arsyeton:

II.1. Me shkresën përcjellëse me nr. 82/25 prot., datë 10.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 908/9 prot., datë 16.04.2026, autortiteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a, ka dërguar me shërbim postar, informacion mbi zbatimin e vendimit të KPP-së Nr. 484/2026, datë 08.04.2026.

*-Procesverbal rivlerësimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 82/24 prot., datë 10.04.2026;*

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik si edhe informacioni i dërguar me shkresën përcjellëse me nr. 82/25 prot., datë 10.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 908/9 prot., datë 16.04.2026, nëpërmjet shërbimit postar, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kryer ri-vlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.484/2026, datë 08.04.2026, duke rivlerësuar arsyet e skualifikimit për OE ankimues “G.A.C” Shpk dhe statusi i këtij OE qëndron përsëri “I skualifikuar”, ku këto veprime janë pasqyruar nga autoriteti kontraktor me informacionin e dërguar, duke bashkëlidhur edhe procesverbalit të rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 82/24 prot., datë 10.04.2026, të nënshkruar nga anëtarët e KVO-së, ku këto veprime janë pasqyruar nga autoriteti kontraktor me informacionin e dërguar si edhe në raportin e auditit të gjeneruar nga sistemi i prokurimit elektronik (SPE).

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedure e Hapur - Punë publike (kontratë me çelsa në dorë)*” me Nr. REF-76024-02-12-2026, me objekt: “Furnizimi me ujë i zonës së Gjirit të Lalzit (*Kontratë me çelsa në dorë)*” me fond limit 65.000.000 (*Gjashtë dhjetë e pesë milion*) lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 02.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Anëtare**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

